



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 46/ Prot.

Tiranë, më 15.04.2025

URDHËR I BRENDSHËM
Nr. 35, datë 15.04.2025

**PËR FILLIMIN E PROCESIT TË MONITORIMIT NË SUBJEKT TË ZBATIMIT
TË LIGJIT PËR NËPUNËSIN CIVIL, ME FOKUS EMËRIMET E REJA DHE
SJELLJEN E NËPUNËSVE CIVILË GJATË PERIUDHËS SË ZGJEDHJEVE TË
PËRGJITHSHME PËR DEPUTETË NË KUVENDIN E SHQIPËRISË**

Bazuar në nenin 14 dhe 15 të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; në Rregulloren e Procedurave të Mbiqëqyrjes dhe Inspektimit, të miratuar nga Komisioneri, si dhe në Urdhrin e Brendshëm nr. 9, datë 14.01.2025, “Për krijimin e grupit të gatshëm dhe organizimin e procesit të monitorimit të zbatimit të ligjit për nëpunësin civil me objekt veprimtarie: emërimet e reja dhe sjellja e nëpunësve civile gjatë procesit zgjedhor”,

URDHËROJ:

1. Fillimin e procesit të monitorimit në subjekt, me objekt verifikimin e zbatimit të ligjit për nëpunësin civil gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë, sipas planifikimit të pasqyruar në tabelat nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, ku përfshihen institucionet subjekt verifikimi, grupi i punës, periudha e verifikimit në subjekt, si dhe planifikimi i përdorimit të bazës logjistike të institucionit (*automjeti i institucionit*). Tabelat janë pjesë e këtij urdhri.
2. Të informohet Komisioneri, në lidhje me ecurinë e procesit të verifikimit, si dhe për problematikën e konstatuar, në koherencë me çdo zhvillim që ka lidhje me këtë aspekt.
3. Në përfundim të procesit të verifikimit, do të hartohen relacionet përkatëse, ku do të sqarohet situata e konstatuar në subjekt.

4. Drejtoria e Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse të sigurojë mbështetjen e grupit të punës me logjistikën e nevojshme, për vijimin normal të procesit.
5. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit; Drejtoria e Çështjeve Juridike, si dhe Drejtoria e Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse.
6. Ngarkohet Drejtoria e Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse që nëpërmjet specialistit të arkiv-protokollit, të njoftojë të gjithë anëtarët e grupeve të punës, si dhe drejtoritë përkatëse të ngarkuara me zbatimin e këtij urdhri.
7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha

